



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1134/5 Prot.

Tiranë, më 17.12.2025

V E N D I M

Nr. 297, Datë 17.12.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 165, datë 23.07.2025¹, e z. Xh.M kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k², me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1134/3, datë 04.08.2025, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Jam një invalid i verbër i grupit të II-të. Me datë 11.07.2025, ora 14:15, hipa në autobusin e linjës Durrës-Plepa, në stacionin e postës në plazh. Erdhi faturino të më priste biletën, unë i thashë jam me librezë dhe i nxora librezën që e kisha të noterizuar, por ai më tha që nuk e njoh këtë, dua origjinalen dhe më kërkoi lekët me këmbëngulje, por unë nuk ja dhashë, por ai filloi të bërtiste nga fillimi deri në fund të autobusit duke më diskriminuar, gjithashtu prezent ishte dhe kontrolli i biletave, gjithashtu dhe ai më tha që nuk njihet e noterizuar. Autobusi kishte targën AA 692 TP.

¹ Ankesa është plotësuar me shkresën e dërguar nga ankuesi, të protokolluar me tonën me nr. 1134/3, datë 04.08.2025.

² NUIS L41720501P.

³ Referuar Librezës së Verbërisë nr. 24972, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, z. M është i verbër Grupi II.

E njëjta gjë më ndodhi me datë 14.07.2025, ora 09:00, kur unë hipa në autobusin në Plepa për në Durrës, ku më qëllloi i njëjti faturino, i cili më kërkoi lekët me këmbëngulje, por unë përsëri nuk ia dhashë, por ai përsëri filloi të fliste nga fillimi në fund të autobusit, duke më diskriminuar në mes të njerëzve. Bashkëshortia ime që ishte prezente, i kërkoi disa herë të pushojë, por ai filloi të debatojë edhe me të, ku në debat u përfshi edhe shoferi i cili i tha bashkëshortes time pusho se të hedh nga autobusi dhe të bëj copash dhe u ngrit nga vendi i tij dhe erdhi tek ne duke më kërcënuar, por bashkëshortja ime i bëri foto dhe video se edhe ajo ishte me librezë (bashkëlidhur fotot). Më ka ndodhur disa herë kjo gjë, por është hera e parë që unë po bëj denoncim. Autobusi kishte targën AA 341 XV.”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1134/4, datë 06.08.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e ankuesit, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

Nga ana e Bashkisë Durrës:

- Kopje të kontratës së shërbimit mes Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë së transportit “Maren Buss” sh.p.k që ushtron aktivitetin në linjën Durrës-Plepa-Durrës.
- Kopje të plotë të licencës të lëshuar nga Bashkia Durrës për mjetet e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, me targa: AA692TP dhe AA341XV.
- Informacion cilat janë masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga ankuesi? Parashtrimet tuaja dhe aktet shkresore provuese, nëse ka.
- Informacion lidhur me monitorimin e shërbimit të operatorëve të transportit të udhëtarëve, me të cilët Bashkia ka marrëdhënie kontraktuale, për periudhën gjatë viteve 2023-2025.

Nga ana e Shoqërisë së transportit “Maren Buss” sh.p.k:

- Informacion nga ana e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në legjislacionin specifik.
- Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Shoqërisë për sqarimin e zgjidhjen e kësaj problematike.

Me shkresën nr. 1134/5, datë 08.09.2025, Komisioneri ka rikujtuar subjektet për dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 1134/4, datë 06.08.2025.

Me shkresën nr. 9705/2, datë 12.09.2025, Bashkia Durrës, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Subjekti “Maren Buss” shpk me Nipt L41720501P është i licencuar dhe kontraktuar nga Bashkia Durrës për kryerjen e shërbimit të transportit të udhëtarëve për linjat qytetase:*

1. *Durrës-Plepa-Durrës, sipas kontratës së shërbimit me Nr. 11460, datë 01.07.2019 lidhur midis palëve: Bashkia Durrës dhe shoqërisë “Maren Buss”, në zbatim të Licencës nr. 1, datë 25.06.2019 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, me afat 10 vjeçar.*
2. *Durrës Qendër-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës Qendër, sipas kontratës së shërbimit me nr. 945111, datë 06.08.2020 lidhur midis palëve: Bashkia Durrës dhe shoqërisë “Maren Buss”, në zbatim të Licencës nr. 2, datë 09.01.2020 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, me afat 10 vjeçar.*

Subjekti ka detyrimin për zbatimin e legjislacionit në fuqi për personat me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimeve në kontratat e lidhura për kryerjen e shërbimit të transportit dhe kushteve të vendosura në licencë, ku ndër kushtet e vendosura në licencë citohet konkretisht:

“Mbajtësi i licencës dhe kësaj certifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

a. Për transportin qytetas:

- “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96.

- “të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”.

Me qëllim verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga ankuesi z. Xh.M, Ju informojmë se menjëherë do të njoftohet Policia Bashkiake Durrës për monitorimin në terren të këtyre dy linjave, në lidhje me zbatueshmërinë apo jo të kushteve të licencimit nga ana e operatorit, për transportin e personave me aftësi të kufizuar. Në vijimësi do ju njoftojmë zyrtarisht lidhur me monitorimin e kryer nga struktura përkatëse e Policisë Bashkiake Durrës.

Monitorimi i kryerjes së shërbimit të transportit të udhëtarëve të linjave qytetase/rrethqytetase në territorin e Bashkisë Durrës, kryhet në terren nga struktura e Policisë Bashkiake Durrës.

Referuar ankesave të depozituara pranë nesh kundrejt linjave të transportit, është kryer monitorimi përkatës dhe Bashkia Durrës në funksionin e autoritetit licencues, rast pas rasti ka kryer njoftimet respektive për këta operatorë të cilët nuk respektojnë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuar”.

Me email-in datë 23.09.2025, Shoqëria “Maren Buss”, informoi Komisionerin se: “Në asnjë rast në linjat e kompanisë tonë nuk ka ndodhur të jetë prerë biletë apo debatuar me persona të cilët kanë dokumentacion të rregullt.

Pasi pyetëm punonjësit e kompanisë për këto raste, ata na kanë shpjeguar që në asnjë rast personat që kanë pas dokumentacion të rregullt nuk kemi kërkuar të paguajnë. Në të vetmet raste që personave u kemi kërkuar të paguajnë ka qenë kur nuk përmbushin rregullin e parashikuar nga ligji, që është minimalja. Mbajtja dhe tregimi i librezës origjinale të invalidit e shoqëruar nga raporti mjeko-ligjor origjinal.

Siç e thotë edhe në shkresën tuaj z. Xh.M ka pasur një fotokopje të noterizuar të librezës dhe nuk ka patur raportin mjeko-ligjor. Pra asnjë dokument origjinal.

Ju vëmë në dijeni se nga Shoqëria Maren Buss sh.p.k ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuar, sipas të gjithë legjislacionit në fuqi jo vetëm për personat e verbër por për të gjithë që

plotësojnë kriteret ligjore. Jo vetëm për këta persona të pajisur me dokumentacionin ligjor origjinal por edhe me një urdhër të brendshëm të gjithë personat e dukshëm fizikisht për aftësitë e kufizuara lejohen të udhëtojnë pa lekë edhe nëse nuk ka dokumentacion.

Në lidhje me sqarimin dhe marrjen e masave për këtë rast sqarojmë se personi nuk është paraqitur asnjëherë pranë zyrave tona dhe nuk kemi asnjë mundësi kontakti për ballafaqim. Jemi të gatshëm në çdo kohë që do kemi një mundësi kontakti për ballafaqim dhe sqarim”.

Me shkresën nr. 9705/4, datë 29.09.2025, Bashkia Durrës, informoi Komisionerin se: “*Bashkia Durrës me shkresën nr. 9705/2, datë 12.09.2025, ka dërguar informacion në përgjigje të kërkesës suaj nr. 1134/4, datë 06.08.2025, ku kemi informuar se do kryhet monitorimi në terren nga Policia Bashkiake Durrës, në lidhje me zbatueshmërinë apo jo të kushteve të licencimit nga ana e operatorit, për transportin e personave me aftësi të kufizuara. Në vijimësi do ju njoftojmë zyrtarisht lidhur me monitorimin e kryer nga struktura përkatëse e Policisë Bashkiake Durrës.*

Bazuar në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar, në kontratat e shërbimit për transportin e udhëtarëve në linjën qytetase, subjektet janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t’i krijojnë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh, kategoritë e veçanta të pasagjerëve kanë të drejtë të udhëtojnë falas në linjat e transportit qytetësë. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi, dokumentin që përcakton ligji për ta”.

Me shkresën nr. 9705/5, datë 06.10.2025, Policia Bashkiake e Bashkisë Durrës, informoi Komisionerin se: “*Në zbatim të ligjit 89/22 “Për Policinë Bashkiake”, si dhe në përputhje me detyrimet për sigurimin e shërbimeve të transportit publik, Sektori i Qarkullimit Rrugor pranë Drejtorisë së Policisë Bashkiake ka monitoruar linjat e transportit publik qytetas Durrës-Plepa-Durrës dhe Durrës Qendër-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës Qendër. Këto linja janë në administrim nga subjekti privat “Maren Buss”.*

Pas verifikimit të këtyre linjave dhe kontaktit me administratorin e kompanisë, është konfirmuar se nuk ka ndodhur asnjë trajtim i diferencuar për kategorinë e personave të verbër të pajisur me librezën e verbërisë.

Ky informacion është marrë direkt nga administratori i firmës, i cili ka siguruar se nuk ka ndodhur asnjë cenim i të drejtave të kësaj kategorie pasagjerësh.

Duke pasur parasysh rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, shërbimet e Policisë Bashkiake janë duke mbajtur në monitorim të vazhdueshëm këto linja të transportit publik, për të shmangur çdo keqkuptim të mundshëm si dhe për të siguruar respektimin e plotë të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1134/10, datë 27.10.2025, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 06.11.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 06.11.2025, pranë institucionit të Komisionerit, me praninë e palës ankuese personalisht, dhe përfaqësuesit të Shoqërisë “Maren Buss”, z. B.A, i autorizuar nga administratori i shoqërisë.

Gjatë seancës dëgjimore, palët parashtruan të njëjta rrethana e fakte si ato të komunikuar shkresërisht pranë KMD-së.

Ankuesi përshkroi dhe njëherë situatën e ndodhur në datë 11 dhe 14 korrik 2025 dhe deklaroi se e përdor shpesh linjën e autobusit, pasi i duhet të shkojë në shkollë. Ankuesi informoi se pas asaj dite nuk ka pasur më situata që ti jetë kërkuar pagesa e biletës së udhëtimit.

Nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë u deklarua se, nuk kanë pasur sinjalizime nga ankuesi apo punonjësit e shoqërisë për këtë rast, por ankuesit i premtoj se jo vetëm që nuk do të ketë nevojë për të treguar librezën, po tek dokumentet e tij do i vendosë, vulën, firmën dhe numrin e tij të telefonit, që nëse në të ardhmen do i krijohet një problematikë e tillë, do merren masa disiplinore për punonjësit.

- Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1134/13, datë 06.11.2025 është administruar pranë Komisionerit, kërkesa për tërheqje nga ankesa e z. Xh.M, si më poshtë: *“Pas seancës dëgjimore dhe deklarimit të përfaqësuesit të shoqërisë Maren Buss, rezultoi që shoqëria ka marrë masa për mospërsëritjen e këtyre situatave. Në këto kushte e quaj të arritur qëllimin dhe tërhiqem nga ankesa”*.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”*.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat reflektuese dhe veprimet konkrete të ndërmarra nga shoqëria “Maren Buss”, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të linjës dhe trajtimin e çdo rasti të raportuar nga përdoruesit e shërbimit;
- Përmbushja e qëllimit të ankesës, pasi pala ankuese ka deklaruar tërheqjen nga ankesa pas sqarimit të plotë të pretendimeve dhe marrjes së garancive nga shoqëria për përmirësimin e situatës;
- Realizimi i qëllimit parandalues dhe ndërmjetësues të procedurës, nëpërmjet zgjidhjes miqësore dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe adresimin në kohë të shqetësimeve të udhëtarëve.

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 165, datë 23.07.2025, të z. Xh.M kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 165, datë 23.07.2025, e z. Xh.M kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k, pa një vendim

⁴ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024.

përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

2. Rekomandohet Shoqëria “Maren Buss” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA